



Npi – 01/176 datë: 29.05.2024

Duke u bazuar në nenet: 12.2 pika (d), nenin 17, pikat (a dhe c) nenin 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-092, Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Nenin 4, neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, neni 24 dhe 25 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës; Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020; Si dhe në bazë të Propozimit të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjerodezi Nr.02/453 dt. 22.05.2024, lidhur me Kërkesën e Operatorit të Sistemit Energjetik të Transmisionit dhe Tregut “KOSTT” SH.A. me numër Nr.1006 të datës 25.04.2024 për Sigurimin e Lokacionit në Shtime për ndërtimin e Nënstacionit Energjetik NS 110 /35/10 (20) KV me sipërfaqe prej 8000m². Kuvendi Komunal, pasi analizoi propozimin e drejtorisë dhe duke marrë për bazë pikën 3 të Rekomandimit të Komitetit për Politikë e Financa me numër Npi – 01/171 të datës: 27.05.2024, në seancën e mbajtur më 29.05.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN KOMUNALE PREJ 8000m² OPERATORIT TË SISTEMIT, TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT “KOSTT” SH.A.

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -V- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 29.05.2024, unanimisht miratoi vendimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, me sipërfaqe prej: 8000 m² (tetëmijë metra katror) Operatorit të Sistemit të Transmisionit e Tregut “KOSTT” sh.a. – Adresa: Rr. “Iljaz Kodra” p.n. 10 000 Prishtinë, Tel:+381(0)38 501-6015, E-mail: info@kostt.com

II

Sipërfaqja e tokës komunale që i është dhënë në shfrytëzimin me kompensim, për 99 vite, Operatorit të Sistemit, energjetik të Transmisionit dhe Tregut “KOSTT” sh.a. me sipërfaqe prej 8000 m², gjendet në pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.P-72809093-01404-11; Zona Kadastrale – Shtime; Evidentuar në emër të “Komuna Shtime” Te vendi i quajtur “Gështenja” në Shtime.

III

ARSYETIM: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme komunale është miratimi i kërkesës me numër Nr.1006 të datës 25.04.2024 të OSTT - “KOSTT” sh.a. për realizimin e projektit të ndërtimit të Nënstacionit të ri Energjetik NS 110 /35/10 (20) KV në Shtime. Rëndësia e realizimit të këtij projekti është shumë e madhe jo vetëm për sa i përket zhvillimit ekonomik, por ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e standardit të jetës për banorët e Komunës së Shtimes dhe më gjerë. Furnizimi stabil me energji elektrike i mbronë të gjitha paisjet nga dëmtimet dhe e shton efikasitetin e tyre të punës, e kursen kohën e punës dhe më kryesorja ndikon drejtpërdrejt në shtimin e investimeve në ekonominë e komunës së Shtimes, me çka do të rritej numri i bizneseve, dhe rritja e numrit të punësuarve.

IV

Pas përfundimit të afatit prej 99 viteve, nga data 29.05.2024, prona i kthehet titullarit të pronës – Kuvendit të Komunës së Shtimes, më datën: 29.05.2024.

V

Sipërfaqja është e lejuar të shfrytëzohet vetëm për zhvillimin e biznesit në përputhje të plotë me Planin Zhvillimor Komunal, legjislationin dhe aktet tjera pozitive në Kosovë, që ka të bëjë me: Nevojat e plotësimit të konsumit me energji elektrike për rajonin e Shtimes, me ndërtimin e Nënstacionit të ri Energjetik NS 110 /35/10 (20) KV në Shtime, me linjat përcjellëse 110kV, ashtu siç është kërkuar me kërkesën Nr.1006 dt.25.04.2024.

VI

Me këtë vendim autorizohet Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, që të kryej punët gjeodezike, matjet, regjistrimin e pronës në librat Kadastral, të hartojë kontratën për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të Komunës me OSTT - "KOSTT" sh.a. të përcjellë implementimin e realizimit të projektit, funksionalizimin dhe implementimin e tërësishëm të këtij vendimi.

VII

Kuvendi i Komunës së Shtimes, rezervon të drejtën që në rast të çfardo dështimi të realizimit të këtij projekti ose mosfunksionalizimit të tij, brenda afatit prej dy viteve, të shkëpusë kontratën njëanshëm dhe ta anulojë këtë Vendim.

VIII

E drejta e fituar nga OSTT - "KOSTT" sh.a. për shfrytëzimin e pronës komunale, sipas dispozitivit të këtij vendimi nuk mund të shitet, trashëgohet, tjetërsohet ose bartet te personat e tretë, me ose pa kompenzim.

IX

Kuvendi i Komunës, kërkon nga Kryetari i Komunës, si përfaqësues Ligjor, që në hartimin e Kontratës përveç të tjerave të përfshihen edhe elementet e këtij Vendimi.

X

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

XI

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal, si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi